



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3137/10 prot.

Datë 25.11.2025

V E N D I M
Nr. 1745/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.11.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1681/2025, datë 14.11.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues: “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe adresë Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë, Shqipëri

Autoriteti Kontraktor: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: “Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1681/2025, ku vendosi:

“[....]

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 15778/9 prot., datë 19.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3137/7 prot., datë 21.11.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1681/2025, datë 14.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me me REF-66832-10-27-2025, me fond

limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 15778/9 prot., datë 19.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3137/7 prot., datë 21.11.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1681/2025, datë 14.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 1681/2025, datë 14.11.2025.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a ka zbatuar vendimin vendimin Nr. 1681/2025, datë 14.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe

licensa”, me me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

